

Maliq më: 06/09/2024

## PROCES-VERBAL-Tipi i Kontratës – SHËRBIME

### **Objekti: “ Shërbime,riparime dhe pjesë këmbimi për mjetin tip kompaktor BOMAG ”**

Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim .  
( Ky proces-verbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit )

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 78, pika 2 e të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ”Administrimi i Mbetjeve të Qarkut Korçë” ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Objekt i kontratës:“**Shërbime,riparime dhe pjesë këmbimi për mjetin tip kompaktor BOMAG”**

### **Fondi Limit :**

**1,485,000** (një milion e katërqind e tetëdhjetë e pesë mijë ) **lekë pa TVSH.**

**1,782,000** (një milion e shtatëqind e tetëdhjetë e dy mijë ) **lekë me TVSH.**

### **KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;  
dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Vetëdeklarimi sipas KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT,

#### **2.2.Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Kopje të deklaratave për xhiron vjetore të viteve **2021, 2022, 2023**, ku mesatarja nuk duhet të jete më e vogël se **30%** e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2.2.2** Kopje të vërtetuar të bilancit për vitet **2022, 2023**, të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;

ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;

iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël

## **Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme ,nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenin 41, të ligjit Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshur “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare”, përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese. Si dhe Ligjin nr 8438 dt 28.12.1998 ”Per Tatimin mbi te ardhurat” i ndryshuar ,ku theksohet ”Çdo tatim pagues pergatit deklaraten vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore tek organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer shërbime të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se 20% e vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë;

a),Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara,

b) Për shërbime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë; 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur në vlerën limit të kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik, duke qenë një kontratë e rëndësishme, mbështetur në sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt prokurimi.

Kjo kërkesë i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat dhe me

cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një “kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

**2.3.2. Operatori Ekonomik** duhet të deklarojë që ka në stafin e tij os të kontraktuar të paktën :

- 1(një) Mekanik
- 1(një) Saldator
- 1(një) Tornitor

Në lidhje me mekanikun, saldatorin dhe tornitorin kërkohet që të paraqitet:

- Kontratë e punës. (e vlefshme)

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Ky numër minimal është kërkuar duke u bazuar në numrin e mjeteve në të cilat do të kryhen shërbimet si dhe natyrën dhe numrin e shërbimeve që kërkohen.

**2.3.3 Operatori ekonomik** duhet të deklarojë se ka në dizpozicion për kryerjen e shërbimeve :

- Pikë servisi në pronësi ose me qera .

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, që të dorëzojë dokumentet provuese, si më poshtë :

**a.** Për piken e servisit në pronësi të paraqitet dokumentacioni i mëposhtëm:

- Çertifikatë pronësie
- Kopje harte
- Kopje karteles

**b.** Për piken e servisit me qera të paraqitet dokumentacioni i mëposhtëm :

- Kontratë qeraje të vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës
- Çertifikatë pronësie
- Kopje harte
- Kopje karteles

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion ambientin për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

**2.3.4 .** Operatori Ekonomik duhet të ketë njohuri për mjetet dhe të disponojë programet për kontrollet me diagnozë për tipin e mjetit dhe motorrit sipas cilësimeve tek Specifikimet Teknike të cilën duhet ta provojë me një deklaratë nga ana e tij ose një marrëveshje bashkëpunimi.

**Argumentimi :** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit..

Ky kriter është vendosur, gjithashtu edhe për arsye se është çmuar si e nevojshme zotërimi i këtyre pajisjeve specifike, të konsideruar nga AK si të domosdoshme për realizimin e shërbimit. Referuar natyrës së objektit të prokurimit për realizimin me sukses të shërbimeve është e nevojshme pajisja e këtyre pajisjeve.

**2.3.5.** Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2023 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” I ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

| <b>Kompaktori Bomag</b> |  |                                   |              |
|-------------------------|--|-----------------------------------|--------------|
| <b>Nr</b>               | <b>Emërtimi i Pjesëve të këmbimit</b>  | <b>Pjesë këmbimi dhe shërbime</b> |              |
|                         |  | <b>Njësia</b>                     | <b>Sasia</b> |
|                         | <b>FILTRA,PJESË</b>  |                                   |              |
| <b>1</b>                | Pompë dozimi (injektor) Ad blu <b>06053200</b> (Bomag) <b>A0001405439</b> (benz).  | copë                              | <b>1</b>     |
| <b>2</b>                | Set guarnicionesh dhe premistopesh pompat e lëvizjes <b>A4VG 85 DA,HT (110)</b> .  | Set komplet                       | <b>4</b>     |
| <b>3</b>                | Set guarnicionesh dhe premistopash të pompës hidraulike pompë drejtuese dhe pune ( pompa treshe) <b>(A10VO/VSO 18-100 DF1)</b> .                                     | Set komplet                       | <b>1</b>     |
| <b>4</b>                | Valvul kontrolli <b>(06052335)</b> .   | copë                              | <b>1</b>     |
| <b>5</b>                | Pompë për ngritjen e naftës me dorë (hand lift pump) <b>06053867</b> .   | copë                              | <b>1</b>     |
| <b>6</b>                | filtër ajri kodi <b>(05821307)</b> .   | copë                              | <b>2</b>     |
| <b>7</b>                | filtër ajri kodi <b>(05821306)</b> .   | copë                              | <b>2</b>     |
| <b>8</b>                | filtër kabine kodi <b>(05578009)</b> .   | copë                              | <b>3</b>     |
| <b>9</b>                | Gominë (loop ring) <b>(06222408)</b> .   | copë                              | <b>3</b>     |
| <b>10</b>               | Fasheta shtrënguese e gjerë <b>(60-80W2;98-103W1;150-170W2 (3x3))</b> .  | copë                              | <b>9</b>     |
| <b>11</b>               | Bateri 12V – 200 Ah  | copë                              | <b>2</b>     |
|                         | <b>SHËRBIME PERIODIKE , SERVICE</b>  |                                   |              |
| <b>1</b>                | ndërrim vaji motorri dhe aksesh,filto, shërbime <b>300</b> orë pune .  | shërbim                           | <b>1</b>     |
| <b>2</b>                | ndërrim vaji motorri dhe aksesh,filto, shërbime <b>500</b> orë pune. Kontrolli i gjendjes së përgjithshme të mjetit (elektronike,elektrike,meکانike,hidraulike etj). | shërbim                           | <b>1</b>     |
| <b>3</b>                | Furnizim-Vendosje pompë (injektor) Adblu-je,programim i injektorit të Adblu me kompjuter pas vendosjes,kontroll i performancës së motorrit.                          | shërbim                           | <b>1</b>     |
| <b>4</b>                | Furnizim-Vendosja e pjesëve të 4 (katër) pompave të levizjes -> çmontim dhe montim në vend <b>A4VG 85 DA,HT (110)</b> .  | shërbim                           | <b>1</b>     |
| <b>5</b>                | Furnizim-Vendosja e pjesëve tek pompa treshe (pompës hidraulike pompë drejtuese dhe pune ) -> çmontim dhe montim në vend <b>(A10VO/VSO 18-100 DF1)</b> .             | shërbim                           | <b>1</b>     |
| <b>6</b>                | Riparim- Shërbime për të gjitha proceset e përshkuara më sipër në ofiçine (në bango).  | shërbim                           | <b>1</b>     |

**Afati për ekzekutimin e Kontratës : Nga i nënshkrimit të Kontratës deri më : 31.05.2025.**

**NJËSIA E PROKURIMIT**

**Roald Neziri**

**Frederik Hamzallari**

**Rudina Bregu**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_